

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit "**Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandimit të Migrantëve në Ballkanin Perëndimor**", mbështetur nga Komisioni Europian

Zhvilluar në bashkëpunim me Grupin 484, Aleancën Qytetare (Mali i Zi), Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas, Vasa Prava (E drejta jote) Bosnje dhe Hercegovinë, Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Programin për të Drejtat Civile në Kosovë dhe Këshillin Danez për Refugjatët

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Shoqata Gazetarë Profesionistë Rajonalë**

Zona e zbatimit: Korçë

Periudha e zbatimit: Gusht 2021-Janar 2022

Titulli i projektit: Media-Polici-Publik përballë emigracionit të paligjshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është parandalimi i sa më shumë rasteve të emigracionit të paligjshëm të shtetasve të huaj që përdorin rrugët ilegale nëpërmjet pikave kufitare të Shqipërisë, për kalim të paligjshëm drejt vendeve të BE-së.

Objektivat specifikë të projektit janë:

1. Krijimi i hapësirave mediatike për publikun mbi 18 vjeç të qarkut të Korçës për denoncimin në policinë e shtetit të rasteve të kalimit të paligjshëm të kufirit dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave që, kundrejt fitimit, u japin ndihmë emigrantëve të huaj që tentojnë të kalojnë drejt vendeve të Bashkimit Europian.
2. Rritja e bashkëpunimit midis medias, policisë rrugore dhe publikut për identifikimin dhe propagandimin në media të rasteve të kalimit të paligjshëm të kufirit të personave të akuzuar për dhënie të ndihmës shtetasve të huaj, kundrejt fitimit, që operojnë në pikat pikat e kalimit kufitar dhe vendkalimet e tjera të vogla kufitare të Qarkut të Korçës, me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut

Rezultatet të cilat synohet të arrihen janë:

- a) Spot televiziv për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me parandalimin e emigracionit të paligjshëm dhe nxitjen e kurajos për denoncimin në polici të rasteve të këtij fenomeni.
- b) 4 vëzhgime gazetareske në katër pikat e kalimit kufitar (Kapshticë, Tre Urat, Qafë Thanë dhe Tushemisht) në lidhje me investigimin e fenomenit të migracionit të paligjshëm
- c) Ëorkshop me pjesëmarrjen e punonjësve të policisë kufitare dhe kriminale, juristëve, përfaqësuesve të bashkisë dhe gazetarëve, në lidhje me dënimet që parashikon ligji për migracionin e paligjshëm dhe masat që duhen marrë nga policia dhe pushteti lokal për parandalimin e këtij fenomeni.
- d) Forum televiziv në lidhje me investigimin e fenomenit të migrimit të paligjshëm me panel të përbërë nga përfaqësues të drejtorisë së policisë, përfaqësues të pushtetit lokal, të taksistëve të licensuar, shoqëruar me opinione të publikut.

- e) Peticion nga taksistët e licensuar drejtuar Prefekturës së Korçës mbi probleme që shkaktohen nga lejimi i ushtrimit të veprimtarisë së taksive të palicensuara dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre jo konform ligjit
- f) 1 raport investigativ mbi gjetjet gazetareske të evidentuara nëpërmjet vëzhgimeve drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë
- g) Konferencë mbi rezultatet përfundimtare të projektit me pjesëmarrjen e grupeve të synuara gjatë projektit